

20182454573

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18 dhe 220/18), në nenin 15 paragrafi (1) pas pikës 1) shtohet pikë e re 2), si vijon:

“2) person në punë praktike në pajtim me ligj”.

Pikat 2), 3) dhe 4) bëhen pika 3), 4) dhe 5).

Neni 2

Në nenin 34 në paragrafët (1) dhe (2) përqindja “0,75” zëvendësohet me përqindjen “1”, përqindja “0,86” zëvendësohet me përqindjen “1,14”, përqindja “0,375” zëvendësohet me përqindjen “0,5”, ndërsa përqindja “0,43” zëvendësohet me përqindjen “0,57”.

Neni 3

Neni 37 ndryshohet si vijon:

“(1) Pensioni harmonizohet prej 1 janarit dhe 1 korrikut çdo vit sipas përqindjes së rritjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës në gjysëmvetorin paraprak në lidhje me gjysëmvetorin i cili i paraprin të shpallura nga Enti Shtetëror për Statistikë. Në rast kur rritja e shpenzimeve të jetesës janë me parashenjë negative, nuk bëhet harmonizimi i pensionit.

(2) Për shkak të zbatimit të paragrafit (1) të këtij neni, pensioni i realizuar në vitin rrjedhës paraprakisht kufizohet në shumë mujore sipas rritjes së neto rrogave nga dhjetori i vitit paraprak në lidhje me neto rrogën mesatare vitin e njëjtë.

(3) Nëse bruto prodhimi vendor në vitin paraprak ka rritje reale më shumë se 4%, përveç harmonizimit nga paragrafi (1) i këtij neni, pensioni harmonizohet prej 1 prillit të vitit rrjedhës në përqindje e cila paraqet dallim ndërmjet shkallës reale të rritjes së bruto rritjes vendore në vitin paraprak dhe shkallës prej 4%.”.

Neni 4

Në nenin 87 në paragrafin (1) fjalët: “nenet 82, 83 dhe 84” zëvendësohen me fjalët: “nenet 82, 83, 84, 91-a dhe 91-b”.

Neni 5

Në nenin 88 në paragrafin (1) fjalët: “nenet 82, 83 dhe 84” zëvendësohen me fjalët: “nenet 82, 83, 84, 91-a dhe 91-b”.

Neni 6

Pas nenit 91 shtohet titull i ri dhe dy nene të reja 91-a dhe 91-b, si vijojnë:

“Të siguruarit nga Agjencia për Zbulim dhe Agjencia Operative – Teknike

Neni 91-a

(1) Të punësuarit me detyra dhe autorizime të veçanta në Agjencinë për Zbulim, stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të rritur edhe atë çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në ato detyra dhe autorizime llogariten si 16 muaj stazh të sigurimit.

(2) I punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni i cili ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluar në mënyrë efektive në vende pune për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të rritur dhe 55 vjet (mashkull), përkatësisht 50 vjet jetë (femër), mund të realizojë të drejtën e pensionit të pleqërisë, nëse marrëdhënia e punës i ndërpritet sipas nevojës së shërbimit.

Neni 91-b

Të punësuarit me statusin e personit të autorizuar në Agjencinë Operative – Teknike, stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të rritur edhe atë çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në ato detyra dhe autorizime llogariten si 16 muaj stazh të sigurimit.

I punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni i cili ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluar në mënyrë efektive në vende pune për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të rritur dhe 55 vjet (mashkull), përkatësisht 50 vjet jetë (femër), mund të realizojë të drejtën e pensionit të pleqërisë, nëse marrëdhënia e punës i ndërpritet sipas nevojës së shërbimit.”.

Neni 7

Neni 118 ndryshohet si vijon:

“(1) Të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) i këtij ligji, me përjashtim të pikave 9) dhe 15) dhe të siguruarit nga nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, të cilët për herë të parë qasen në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor pas 1 janar të vitit 2019 dhe në datën e qasjes janë më të ri se 40 vjet janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë pensionale dhe paguajnë kontribut në fondin e detyrueshëm pensional me zgjedhje personale deri sa kanë cilësi të të siguruarit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(2) Të siguruarve të cilët janë anëtarë në shtyllën e dytë pensionale sipas nenit 118 të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18 dhe 220/18) dhe të cilët kanë lindur pas 1 janarit 1967 u vazhdon anëtarësimi në shtyllën e dytë pensionale.

(3) Të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të rritur dhe të siguruarit nga Kreu VII – Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve me kushte të veçanta, nuk përfshihen në shtyllën e dytë pensionale.

(4) Të siguruarit nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni të cilët gjatë sigurimit do të fitojnë bazë të sigurimit sipas nenit 11 paragrafi (1) pikat 9) dhe 15) të këtij ligji ose gjatë sigurimit u përcaktohet stazhi i sigurimit me kohëzgjatje të rritur, pushojnë të jenë anëtarë në shtyllën e dytë pensionale.

(5) Me përjashtim nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit u përcaktohet në pajtim me nenin 100 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji të cilët janë në marrëdhënie pune ose persona të vetëpunësuar me orar të plotë pune dhe për të cilët është përcaktuar lirim nga pagimi i kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, nuk janë anëtarë të detyrueshëm në shtyllën e dytë pensionale për periudhën për të cilën është përcaktuar lirimi nga pagimi i kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social.”.

Neni 8

Neni 119 ndryshohet si vijon:

“Të siguruarve anëtarë në shtyllën e dytë pensionale sipas nenit 119 të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18 dhe 220/18) u vazhdon anëtarësimi në shtyllën e dytë pensionale.”.

Neni 9

Neni 132-a shlyhet.

Neni 10

Në nenin 157 paragrafi (1) në pikën 6) pas fjalës “Fondi” shtohen fjalët: “edhe mjetet nga kompensimi për kryerjen e punëve që i janë përcaktuar me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital”.

Neni 11

Në nenin 159 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

“(5) Pas emërimit të drejtorit, përkatësisht zëvendësdrejtorit të Fondit lidhet marrëveshje e menaxherëve ndërmjet drejtorit të emëruar përkatësisht zëvendësdrejtorit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.”.

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (6), (7) dhe (8).

Neni 12

Në nenin 161 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Për planin vjetor për punësim mendim jep Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.”.

Në paragrafin (3) numri “30” zëvendësohet me numrin “1”.

Neni 13

Pas nenit 164 shtohen dy nene të reja 164-a dhe 164-b, si vijojnë:

“Neni 164- a

(1) Të punësuarit në shërbimin profesional të Fondit klasifikohen në këto kategori dhe nivele:

- kategoria B – nëpunës administrativë udhëheqës
- niveli B1 nëpunës udhëheqës nga niveli i parë (drejtor i sektorit, këshilltar i drejtorit dhe shef i kabinetit të drejtorit),
- niveli B2 nëpunës udhëheqës nga niveli i dytë (udhëheqës i Komisionit për vlerësim të aftësisë punuese, udhëheqës i filialit Shkup, koordinator i sektorit, udhëheqës i seksionit – informatikë, udhëheqës i seksionit për revizion të brendshëm, mjek specialist, informatikan grupi I dhe udhëheqës i degës për aktuari),
- niveli B3 nëpunës udhëheqës nga niveli i tretë (udhëheqës i seksionit – Qendrës, udhëheqës i filialit nga grupi I, informatikan nga grupi II, analist aktuar nga grupi II dhe ndihmës udhëheqës i Filialit Shkup) dhe
- niveli B4 nëpunës udhëheqës nga niveli i katërt (udhëheqës i Filialit nga grupi II, udhëheqës i përfaqësisë, mjek dhe informatikan nga grupi III),
- kategoria V – nëpunës administrativë profesionalë
- niveli V1 nëpunës administrativ profesional nga niveli i parë (udhëheqës i degës – Qendrës, bashkëpunëtor profesional – Qendra, udhëheqës i degës – Filialit, kontrollor – Qendra, kontrollor – Filiali Shkup),
- niveli V2 nëpunës administrativ profesional nga niveli i dytë (revizor i brendshëm i trajnimit, bashkëpunëtor – Qendra, kontrollor në Filialin Shkup, korrespondent, përkthyes – lektor në Qendër),
- niveli V3 nëpunës administrativ profesional nga niveli i tretë (bashkëpunëtor – Qendra, bashkëpunëtor – Filiali) dhe
- niveli V4 nëpunës administrativ profesional nga niveli i katërt (bashkëpunëtor – Qendra, bashkëpunëtor në Filialin, korrespondent, përkthyes – lektor në Filialin, kontrollor) dhe
- kategoria G – nëpunës profesionalë – ndihmës

- niveli G1 nëpunës profesional – ndihmës nga niveli i parë (sekretar teknik, sekretar teknik – administrator, operator, referent, kontrollor, organizator, likuidues – analist, arkëtar, kontabilist, teknik,),

- niveli G2 nëpunës profesional – ndihmës nga niveli i dytë (nëpunës profesional nga niveli i dytë (referent nga niveli i dytë, operator nga niveli i dytë, arkivist - administrator),

- niveli G3 nëpunës profesional – ndihmës nga niveli i tretë (arkivist – administrator nga niveli i tretë, arkivist, operator nga niveli i tretë, referent nga niveli i tretë, daktilograf) dhe

- niveli G4 nëpunës profesional – ndihmës nga niveli i katërt (likuidues, operator, referent nga niveli i katërt, arkivist – sekretar nga niveli i katërt).

(2) Klasifikimi i vendeve të punës në nënnivele në kuadër të nivelit të njëjtë nga paragrafi (1) i këtij neni janë:

-niveli B1 – nënniveli B1/1, B1/2 dhe B1/3,

-niveli B2 – nënniveli B2/1, B2/2, B2/3 dhe B2/4,

-niveli B3 – nënniveli B3/1, B3/2, B3/3 dhe B3/4,

-niveli B4 – nënniveli B4/1, B4/2 dhe B4/3,

-niveli V1 – nënniveli V1/1, B1/2 dhe B1/3,

-niveli V2 – nënniveli V2/1 dhe B2/2,

-niveli V3 – nënniveli V3/1 dhe B3/2,

-niveli V4 – nënniveli B4/1, B4/2 dhe B4/3

-niveli G4 – nënniveli G4/1 dhe G4/2.

(3) Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (kualifikimet profesionale dhe përvoja e punës) në nivelet dhe nënnivelet e vendeve të punës sipas titujve të theksuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni do të përcaktohen në Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 164-b

(1) Rrogat e të punësuarve në shërbimin profesional të Fondit nga neni 164-a paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji, përllëgariten sipas pikëve në kategoritë si vijojnë:

- kategoria B prej 540 deri 716 pikë,

- kategoria V prej 430 deri 540 pikë dhe

- kategoria G prej 300 deri 400 pikë.

(2) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të nëpunësit administrativ vlerësohet në shumë prej 0,5% të pjesëve të rrogës për shkallën e arsimit dhe për nivelin, për çdo vit të përfunduar stazh pune, ndërsa më së shumti deri në 20%.

(3) Vlera e pikës për llogaritjen e rrogave të nëpunësve administrativë nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet çdo vit me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Financave dhe ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, i cili miratohet në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, dhe në kuadër të buxhetit të parashikuar dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të nëpunësve administrativë të sistemuar në nivelet përkatëse për vitin rrjedhës.

(4) Shtesat e rrogës së nëpunësit administrativ përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.”.

Neni 14

Në nenin 191 para fjalisë hyrëse shtohet numri “(1)”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Mjetet nga kompensimi për kryerjen e punëve që i janë përcaktuar Fondit në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, mund të shfrytëzohen për kryerjen e punëve të Fondit të cilat kanë të bëjnë me:

- vendosjen dhe përparimin e proceseve afariste të Fondit në lidhje me anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale dhe shpërndarjen e mjeteve në shtyllën e dytë pensionale,
- vendosjen dhe përparimin e proceseve afariste të Fondit në lidhje me realizimin e pensionit nga shtylla e parë dhe e dytë pensionale dhe
- përparimin e sistemit informatik të Fondit.”.

Neni 15

Në nenin 228 në paragrafët (2) dhe (4) pas fjalëve: “viti 2013” shtohen fjalët: “deri më 31 dhjetor të vitit 2018”.

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

“(5) Për të siguruarit nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni për çdo vit të mëtutjeshëm stazh pune të plotësuar pas 1 janarit 2019 deri më 31 dhjetor 2019, pensioni llogaritet në lartësi prej 1,54%, ndërsa për stazh pensional më të shkurtër se një vit, dhe së paku gjashtë muaj pensioni llogaritet në lartësi prej 0,77%. Për stazh pune të plotësuar pas 1 janarit 2020 pensioni llogaritet në lartësi prej 1,47%, ndërsa për stazh pensional më të shkurtër se një vit, dhe së paku gjashtë muaj pensioni llogaritet në lartësi prej 0,735%.”.

Neni 16

Aktet nënligjore miratimi i të cilave është përcaktuar me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2019, përveç dispozitave të nenit 9 të këtij ligji me të cilat shlyhet neni 132-a të cilat do të fillojnë të zbatohen nga 1 prilli 2019 dhe dispozitave të nenit 13 të këtij ligji, me të cilat shtohen dy nene të reja 164-a dhe 164-b, të cilat do të fillojnë të zbatohen nga 1 qershori 2019.